



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 janar 2013
Nr. ref.: RK377/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI91/12

Parashtruesi

Ali Latifi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, është Vendimi për caktimin si avokat mbrojtës, i lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar numrin karakteristik, as datën e nxjerrjes dhe as datën e pranimit të tij, ndërsa vendimi ka të bëjë me rastin HP-155/12.

Objekti i çështjes

3. Objekt i lëndës së parashtruar më 10 shtator 2012, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës të parashtruesit të kërkesës, i lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i tregojë nëse parashtruesi duhet ose jo të jetë avokat mbrojtës i të pandehurit S. P, i cili akuzohet për krime lufte.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe neni 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 31 tetor 2012, me Vendimin GJ. R. KI91/12, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 25 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që, në përputhje me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në përputhje me rregullin 36 të Rregullores, të plotësojë formularin e Gjykatës dhe t'i sjell vendimet gjyqësore, provat dhe dëshmitë e nevojshme, për procedim dhe për shqyrtim të kërkesës.
8. Parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur asnjërës kërkesë të parashtruar nga Gjykata.
9. Më 15 nëntor 2012, Gjykata kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën me vetëm një faqe.
11. Parashtruesi e kishte adresuar të njëjtën kërkesë në këto institucione:

Oda e Avokatëve të Republikës së Kosovës,
Ministria e Drejtësisë e Qeverisë së Kosovës,
Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës,

Prokuroria e Shtetit e Kosovës dhe Prokurorët e Qarqeve,
EULEX,
Prokuroria Speciale e Kosovës,
Gjykata Supreme e Kosovës, dhe
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

12. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin për caktimin si avokat mbrojtës, e lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12, ku parashtruesi caktohet si avokat mbrojtës i të pandehurit S. P.

S. P. ngarkohet për krime të kryera ndaj popullatës civile në Krushë, KK Prizren (Ky vendim nuk gjendet në shkresat e lëndës).

13. Parashtruesi i kërkesës thekson se e ka informuar Prokurorinë e EULEX-it, nëpërmjet Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe ka kërkuar të dijë se a mund të jetë i caktuar si avokat mbrojtës për shkak se, siç thekson, “më 20 gusht 1998, në Hagë, dhe më 6 shtator 2003, në Prokurorinë e Kosovës, ka iniciuar procedurën për krimet e luftës ndaj popullatës civile që ka bërë shteti serb ndaj popullatës së Kosovës”.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës nuk ka precizuar se cilat të drejta, të mbrojtura me Kushtetutë, i janë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

16. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura pranë Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

17. Në rastin konkret, parashtruesi:

- a. nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion mbështetës për shqyrtim të kërkesës së tij, dhe
b. nuk ka ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

18. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh:

Rregullin 36, par. 3, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

f) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën”.

19. Gjykata thekson se pajtueshmëria e ndonjë kërkesë *ratione materiae* me Kushtetutën rrjedh nga kompetenca substanciale për juridiksionin e Gjykatës, e paraparë me nenin 113 të Kushtetutës, dhe veçanërisht me nenin 113.7, kur bëhet fjalë për kërkesat individuale.
20. Që një kërkesë të jetë e pajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta për të cilën pretendohet se i është shkelur parashtruesit të kërkesës duhet të jetë e garantuar dhe e mbrojtur me Kushtetutë.
21. Në këtë drejtim, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrton vetëm rastet që ngrihen për shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Protokolleve të saj, dhe jo edhe të të drejtave të garantuara me instrumente të tjera juridike, apo që janë jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate. (*Shih, Peñafiel Salgado kundër Spanjës, Aplikacioni nr. 65964/01, i 16 prillit 2002, dhe X kundër Holandës, Vendimi i GJEDNJ-së, i 4 tetorit 1976*).
22. Z. Latifi nuk kishte përcaktuar në kërkesën e tij se cila nga të drejtat e garantuara me Kushtetutë i është shkelur atij, ndërsa, nga teksti i kërkesës së dërguar, Gjykata nuk mundi të konstatojë se ndonjëra e drejtë që garantohet me Kushtetutën e Kosovës do të mund të ishte objekt i shkeljeve eventuale.
23. Çështja e caktimit si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, vetë për vete, nuk është çështje kushtetuese dhe nuk është e përcaktuar me asnjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë, në të cilën do të mund të thirrej parashtruesi i kërkesës.
24. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kornizës juridike të paraparë me nenin 113.7, andaj, në përputhje me nenin 36, par. 3 (f), kërkesa deklarohet e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë *ratione materiae* me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.3 pika (f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović




Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

